



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.71-1/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Nenad Llazic dhe Adnan Koushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanicë e paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr 71/2017 të datës 07.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Miratohet** si i bazuar apeli i Progresivna Demokratska Stranka (PDS), për rishqyrtimin e vendimit Anr. 71/2017 të datës 07.06.2017.

**II. Ndryshohet pjesa I. e dispozitivit**, të vendimit të PZAP-it Anr. 71/2017 të datës 07.06.2017, lidhur me shqiptimin e gjobës, kështu që subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka me seli në Graçanicë, i revokohet sanksioni i shqiptuar me gjobë në lartësi prej 1300 (njëmijë e treqind) euro. Në pjesën tjetër, dispozitivi vendimit të ankimuar mbetet i pandryshuar.

## A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën kryesore në qytezën e Graçanicës në rrugën Petar Lazër, monitoruesi i tyre ka hasur ne poster të subjekteve politike Gragjanska Iniciativa Srpska Lista si dhe të subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) të ngjitura në hapësirë publike, përkatësisht në shtyllë publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017 të subjekti politik PDS thekson se subjekti i tyre politik ka respektuar Ligjin nr.03/L-073, Rregulloren Zgjedhore nr.11/2013 dhe sipas kësaj të gjithë aktivistët e tyre janë njoftuar qartë me udhëzimet se ku lejohet të ekspozohen posteret politike gjatë fushatës zgjedhore. Në vazhdim ka theksuar dikush nga aktivistët, për shkak mos dijes, kanë vendosur postere në vendet ku nuk lejohet vendosja e tyre, me ç'rast menjëherë janë evituar parregullësia e vërejtur.

Duke marr parasysh faktin se ka ndërmarr masat korrektuese dhe i kanë evituar parregullsitë, si dhe shkelja e pretenduar nuk është bërë qëllimisht por pa dashje, ka kërkuar që të pranohet kërkesat e tyre dhe që mos të shqiptohen gjobat apo sanksione tjera ndaj subjektit të tzre politik. Në mbështetje pretendimeve në ankesë ka bashkangjitur fotografite nga terreni pas ndërmarrjes së masave korrektuese nga ana e subjektve politik.

Me pjesën I dispozitivit të vendimit vendimin Anr.71/2017 data 07.06.2017 subjektit politik Progresivna Demokrtaska Stranka (PDS) në Graçanië i është shqiptuar sanksioni me gjobë në shumën prej 1300 euro.

Kundë vendimit të cekur më lartë subjektit politik PDS ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit Anr.71/2017 datës 07.06.2017 lidhur me gjobën e shqiptuar me arsyetim se ndaj këtij subjekti me vendimin Anr 89/2017 lidhur me shkeljen në fjalë njëhere i është i është shqiptuar sanksioni me gjobë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Apeli është i bazuar**

Paneli pasi shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim të subjektit PDS vlerësoi se e njëjta është e bazuar për faktin se subjekti politik PDS ka paraqitur fakte të reja konkretisht vendimin e PZAP Anr89/2017 ku shifet se ndaj subjektit të njejtë politik është vendosur për shkeljen e njejtë. Me dispozitë e nenit 118. 4 të LZP është paraparë që mund të apelohe vendimi PZAP-it , sikurse që PZAP mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezentimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Paneli në rastin konkret vlerësoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga nenit 118. 4 të LZP që të rishikohet vendimi i PZAP-it, andaj miratoj kërkesën për rishikim të ankuesit.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 i LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.71-1/2017 më datën 12.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.